



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:191070

Datë: 17.10.2024

Numri i dokumentit: 06311859

C.nr.3248/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështje juridike kontestimore të paditësit G.M. me numër personal nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. B.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, me objekt kontesti: kompensim dëmi, vlera e kontestit 2000 euro, jashtë seance, më datë 17.10.2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

-Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia-

REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit G.M. nga Prizreni, komuna e Prizrenit,, *me të cilën ka kërkuar që të “ Aprovohet padia dhe kërkesë padia e paditësit G.M. nga Prizreni, në tërësi si e bazuar obligohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Prisig” me seli në Prishtinë - që në emër të dëmit material dhe jo material –që ka pësuar si pasojë e lëndimeve të pësuar në aksident trafiku me datë 30.07.2022, t’i paguaj shumën prej 2000 euro, si dhe t’ia paguajë shpenzimet procedurale, ”. si e pabazuar.*

A r s y e t i m

Paditësi G.M. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson Av. B.M. nga Prizreni, me datën 19.09.2022, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Illyria” me seli në Prishtinë, duke theksuar se me datë 30.07.2022, rreth orës 13:30, deri tek aksidenti kishte ardhur kur dy automjetet ishin duke qarkulluar në Autostradën Prizren-Gjergjicë, me të arritur në KM 48, dyshohet se drejtuesi i automjetit A duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes humb kontrollin dhe fillimisht me pjesën e parë të anës së djathtë godet mbrojtësit e metaltë të rrugës në anën e djathtë të drejtimit të lëvizjes. Pas goditjes duke e bartur kalon në shiritin e djathtë po ashtu me pjesën e parë të anës së djathtë godet automjetin B pjesën e pasme të anës së djathtë, pas kësaj goditje automjeti A godet edhe mbrojtëset e metaltë të mesit të rrugës dhe mbetet në pozitë përfundimtare, kurse automjeti B pas goditjes së marrë nga automjeti A humb kontrollin ku me pjesën e parë godet mbrojtësit e metaltë të mesit të rrugës dhe rrokulliset pas rrokullisjes duke bartur kalon në shiritin emergjent ku godet mbrojtësit e metaltë të rrugës dhe mbetet në pozitën përfundimtare i rrokullisur në krahun e majtë. Si pasojë e këtij aksidenti lëndime trupore ka pësuar i dëmtuari.

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 07.10.2024 për heqjen dorë nga kërkesëpadia e njofton gjykatën se me të paditurën kanë arritur marrëveshje jashtë gjyqësore të cilën ia ka bashkangjitur parashtrësës dhe mbi këtë bazë i propozon Gjykatës që të nxjerrë aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia.

Me nenin 3 par. 1 të LPK-së është paraparë se *“Palët mund të disponojnë lirisht me kërkesat juridiko – civile që i kanë parashtruar gjatë procedurës”*, ndërsa me par.2 të këtij neni është paraparë se *“Palët mund të heqin dorë nga kërkesat e tyre, ta njohin kërkesën e palës kundërshtare si dhe të bëjnë pajtim gjyqësor lidhur me kontestin e tyre”*.

Gjykata, pas heqjes dorë nga kërkesëpadia nga ana e paditësit, konstatoi se kërkesat janë të disponueshme për palët, prandaj, në kuptim të nenit 149, paragrafit 1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK-së) – me të cilin përcaktohet se *“në qoftë se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes heqë dorë nga një pjesë e kërkesëpadiës apo nga e gjithë kërkesëpadia, gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi (aktgjykimi në bazë të heqjes dorë)”* – pa shqyrtim të mëtejshëm vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Nga sa u tha më lartë, e bazuar në nenin 3 par. 1 dhe par. 2, lidhur me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.3248/2022, datë 17.10.2024

G j y q t a r i

Taulant Rexhëbeqaj

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Në kuptim të nenit 181, paragrafit 2 të LPK-së, ankesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se heqja dorë nga kërkesëpadia është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.